



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PEQIN

DREJTORIA PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. \_\_\_\_ .Prot

Peqin ,më 18.01.2024

**PROJEKT-VENDIM**

Nr \_\_\_\_ dt \_\_\_\_ .2024

Për

**Nxjerrjen jashtë funksioni 'TREGU DITOR', pranë Kalasë Peqin .**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" si dhe ligjit nr.107 dt.31.07.2014 "Për Planifikimin e Territorit", Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit propozon në mbledhjen e radhës me datë \_\_\_\_ .01.2024 të Këshillit Bashkiak Peqin:

**PROPOZOJ:**

1. Nxjerrjen jashtë funksioni të "Tregut ditor" me sipërfaqe 185m<sup>2</sup>, me vlerë 3.244.825 ndodhur në pasurinë me nr.13/22/2, në zonën kadastrale 2908 E-3, pranë Kalasë Peqin.
- 2.Heqjen nga llogaria 212.

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

DREJTORI

Johan SALLUFI



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
BASHKIA PEQIN  
DREJTORIA PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Peqin , më 19/ 01/2024

RAPORTI TEKNIK

Për:

**OBJEKTI:** Nxjerrje jashte funksioni i objektit "Ish/Tregu Ditor" me nr.13/22/2 pasurie, sip. nderteses 185m2, Z.K. 2908, PE-E-3, Qyteti Peqin, Bashkia Peqin.

Objektit "Ish/Tregu Ditor" me nr.13/22/2 pasurie, sip. nderteses 185m2, Z.K. 2908, PE-E-3, ndodhet ne qytetin Peqin dhe eshte ndertuar ne vitin 2007 me vlere 3.244.825 leke.

- Ky objekt eshte ndertuar pa nje studim te pjesshem, plan te detajuar dhe sjell prishjen e harmonise se urbanizimit te qendres se qytetit, si dhe zenien e sheshit te pallatit qe ka prane.  
Ndertimi i ketij objekti eshte bere me parametra jo te pershtatshme per nje treg. Pra, siperfaqja funksionale prej 185 m2 nuk eshte e mjaftueshme per nje treg qe te mbuloje nevojat qe ka komuniteti per nje treg ditor. Materialet e perdorura si mbulesa me llamarine e bejne te pa pershtatshme kete treg dhe jo bashkohor sidomos ne ditet e nxehta. Si te tilla e kane bere kete treg te pa perdorshem, dhe tregu funksiononte jasht ketij ambjenti ne kushte te papershtatshme.  
Dalja jashte funksionit i ketij tregu ka bere qe Bashkia te mos e perdore kete treg dhe te ndertoje nje treg ditor tjeter.
- Ky objekt eshte ndertuar brenda "Zones se mbrojtur" te Kalase se Qytetit, qe eshte perfshire ne Kategorine e Monumenteve te Kultures, subjekt i ligjit Nr.27/2018 "Per trashegimine kulturore dhe muzete".
- Plani i Pergjithshem Vendor, i Rregullores Vendore te Bashkise Peqin te miratuar me Vendim te Keshillit kombetar te Territorit nr.3, date 28/12/2020, sugjeron qe ne kuader te ruajtjes se peizazhit vendosjen e nje zone mbrojtese me gjeresi prej 100m te objektit te kalase se qytetit per te krijuar rregulla dhe per objektet e reja ne zonen, me distance prej 100m qe mund te kthehen ne pengesa vizive te objektit-monument kulture dhe atraksion turistik.

- Me vendim Nr,228,date 26.07.2017, Keshilli Shkencor i Institutit te Monumenteve te Kultures, ka miratuar Projektin"Restaurimi i Kalase se Peqinit" , projekt elektrik qe ka per qellim ndricimin e mureve te kalase dhe ambienteve perreth, nga ku, ky objekt bie ndesh me harmonine e kalase.
- Nisur nga ankesat dhe kerkesat e komunitetit dhe te banoreve te pallateve perreth per shqetesimin qe sjell ky objekt nga zenia e hapsires publike (sheshit te pallatit) si dhe ndotjes dhe zhurmat nga amortizimi i tij nga dalja jasht funksionit, si dhe arsytet qe cituam me lart, Bashkia Peqin ka vendosur:  
**Nxjerrjen jashte funksionit te ketij objekti dhe me ane te projektit , Objekti:"Rikualifikimi sheshit prane kalase se qytetit" me investitor Fondi Shqiptar te Zhvillimit ,ta ktheje kete shesh ne nje shesh te urbanizur dhe rekrativ per ti sherbyer banoreve te pallateve dhe komunitetit.**
- Materialet qe do te meren nga prishja e objektit si kapriatat metalike,dyer dhe dritare metalike, mbulesa llamarine si dhe materjalet e tjera do te magazinohen dhe do te perdoren per nevojat qe ka Bashkia.

Koncept:  
Specialisti:  
I.Zyba.  
Aktek.  
Enxhi Meta.  
Drejtori i DPZHKT-se  
Johan SAELUFI

